



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KORÇË

Nr.232-2021 Regj.
Nr. 1317 Prot.

Korçë, më datë 29/03/2022

V E N D I M

(PËR SHPALLJEN E SHITJES NË ANKAND TË TRETË PASURISË SË PALUAJTSHME)

Në Korçë, sot më datë 29/03/2022

Unë **Brunilda Bica**, Përmbareuese Gjyqësore pranë Zyrës Përmbareuese Korçë, pasi studiova materialet e dosjes përmbareuese nr.232-2021 Regj., datë 20/12/2018, në zbatim të “Urdhërit të Ekzekutimit” nr.901/U, datë 11/02/2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar për (titullin ekzekutiv) vendimin gjyqësor nr.901, datë 11/02/2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

K O N S T A T O V A:

Se në datën 20/12/2018 është regjistruar pranë Zyrës Përmbareuese Korçë kërkesa e (kreditorit) Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural(A.ZH.B.R.), së bashku me “Urdhërin e Ekzekutimit” nr.901/U, datë 11/02/2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar për (titullin ekzekutiv) vendimin gjyqësor nr.901, datë 11/02/2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë:

Kreditor: Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural(A.ZH.B.R.)

Debitor: Agron Zaim Gjata

Me objekt: Pagim shume

Lidhur me ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv nga ana jonë kanë vazhduar procedurat ligjore bazuar në dispozitat e K.Pr.Civile dhe ligjin nr.8730, datë 18/01/2001 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit të Përmbareimit Gjyqësor”(i ndryshuar).

Me urdhërin nr.4044 Prot., datë 15/01/2019 është vendosur sekuestro konservative në pasurinë e paluajtshme:

-Pasuria me nr.130/3, vol.4, fq.116, ZK.1817, pasuri e llojit Arë+Truall, me sip. totale 600 m², nga të cilat 300 m² truall, nga të cilat 240 m² ndërtesë, adresa e pasurisë: Goskovë e Sipërme, Rrethi Korçë, regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Korçë, në emër të (debitorit)Agron Zaim Gjata.

Me aktin teknik, Raport-Vlerësimin subjekti Multi-Studio 21, me administrator z.Jani Stratoberdha ka përcaktuar se vlera e pasurisë së paluajtshme: Pasuria me nr.130/3, vol.4, fq.116, ZK.1817, pasuri e llojit Arë+Truall, me sip. totale 600 m², nga të cilat 300 m² truall, nga të cilat 240 m² ndërtesë, adresa e pasurisë: Goskovë e Sipërme, Rrethi Korçë është 1,984,440 lekë.

Me shkresën nr.357-2020 Regj./nr.2051 Prot., datë 17/07/2020 në bazë të nenit 567 të K.Pr.Civile, është lajmëruar (debitori) Agron Zaim Gjata se nëse brenda 10(dhjetë) diteve të njoftimit nuk do të përmbushet detyrimin, sendi i sekuestruar do të shitet në ankand.

Sipas akteve të administruara në dosjen përmbare, nuk rezultojnë të jetë përmbushur i gjithë detyrimi nga debitori.

Në datë 04/02/2021 u shpall ankandi i dytë për shitjen e sendit të sekuestruar.

Procedura e ankandit të dytë vazhdoi 30(tridhjetë) ditë dhe përfundoi më mbarimin e orarit zyrtar në datë 11/03/2021.

Nga procedura e zhvillimit të ankandit të dytë si dhe nga procesverbali i datës 11/03/2021 të zhvillimit të tij rezultoi se në të gjithë afatin 30-ditor të mbajtjes së afishimit të shitjes së sendit të paluajtshëm, ashtu si dhe ditën e zhvillimit të tij, nuk u paraqit asnjë ofertues për blerjen e sendit të paluajtshëm të përcaktuar me një çmim në vlerën 1,111,286.4 lekë.

Çdo veprim i kryer nga ana jonë për ekzekutimin e titullit ekzekutiv iu është komunikuar palëve, duke iu dhënë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë sipas ligjit.

Për këto arsye: Bazuar në nenet 568, 570 e 577 të K.Pr.Civile, ligjin nr.8730, datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit të Përmbaremit Gjyqësor"(i ndryshuar) dhe udhëzimin nr.5, datë 12/12/2012 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbaresi gjyqësor", unë Përmbarese Gjyqësore Brunilda Bica

V E N D O S A:

1- Shpalljen e shitjes në ankand të tretë të pasurisë, si më poshtë:

Pasuria me nr.130/3, vol.4, fq.116, ZK.1817, pasuri e llojit Arë+Truall, me sip. totale 600 m², nga të cilat 300 m² truall, nga të cilat 240 m² ndërtesë, adresa e pasurisë: Goskovë e Sipërme, Rrethi Korçë, regjistruar në emër të (debitorit) Agron Zaim Gjata.

Me këtë shpallje njoftoj të gjithë të interesuarit, duke i

INFORMUAR SE:

1- Çmimi fillestar në ankandin e tretë të hapur publik është jo më i ulët se 10 % (përqind) i çmimit të përcaktuar në ankandin e dytë prej 1,111,286.4 lekë -111,128.64 lekë = 1,000,157.76 lekë.

2- Vendi ku do të zhvillohet ankandi i tretë i hapur publik i shitjes së sendit është Zyra Përmbare Korçë, e cila gjendet në adresën: Rruga "28 Nëntori", Nr.1, Lagjia Nr.7, Korçë (ish Bashkia Korçë).

3- Ankandi i tretë i hapur publik për shitjen e sendit të paluajtshëm shpallet sot më datë 29/03/2022 dhe do të qëndrojë i publikuar deri në datë 05/05/2022, ditën e Enjte, ora 16.30.

4- Dorëzimi i kërkesave për pjesëmarrje në ankandin e hapur publik të tretë do të pranohen në të gjithë afatin e shpalljes dhe procesi përfundimtar i zhvillimit të ankandit do të kryhet në datë **05/05/2022**, ditën e **Enjte** duke u mbyllur në orën **16.30** me mbarimin e orarit zyrtar.

5- Çdo ofertues që është i interesuar për blerjen e pasurisë në ankand, është i detyruar të paraqitet personalisht dhe/ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij/saj me prokurë, si dhe të dorëzojë (brenda në zarf të mbyllur) në zyrën e përbarimit gjyqësor(Zyrën Përbarimore Korçë) deri në orën 16.30, këto dokumenta:

- a) Kërkesen e tij/saj për pjesmarrje në ankand
- b) Faturën bankare të 10% të garancisë për pjesmarrje në ankand(në origjinal)
- c) Dokumentin e identifikimit(Kartë identiteti ose Pasaportë)

6- Çdo ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të procedurave të shqyrtimit të ofertave, në datën 05/05/2022, ditën e Enjte, ora 16.30, është i detyruar të depozitojë si garanci pranë Credins Bank Sh.a., dega Korçë, në nr.llogarie 153916 të Zyrës Përbarimore Korçë një shumë të hollash të barabarta me 10% të çmimit të pasurisë të caktuar në shpallje. Kreditori nuk le garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë.

7- Debitori dhe/ose përfaqësuesi i tij ligjor, përbaruesi gjyqësor, si edhe personat e tjerë që listohen në nenin 709 të Kodit Civil, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand.

8- Gazeta “Panorama” dhe Gazeta “Shqiptare”, sipas detyrimit që rrjedh nga neni 568 i K.Pr.Civile, këtë vendim detyrohen ta publikojnë 5(pesë) ditë me rradhë, në gazetat e tyre. Për shërbimin e kryer, pala kreditore merr përsipër pagimin e shumës e cila më pas sipas nenit 525 të K.Pr.Civile i ngarkohet debitorit.

9- Ky vendim hartohet në 11(njëmbëdhjetë) kopje: 1(një) kopje administrohet në dosjen përbarimore, 1(një) kopje afishohet në ambientet e Zyrës Përbarimore Korçë, 1(një) kopje afishohet në vendin ku ndodhet pasuria e paluajtshme(nëpërmjet Njesisë Administrative Voskop, Bashkia Korçë); 1(një) kopje i njoftohet debitorit; 1(një) kopje i njoftohet kreditorit; 3(tre) kopje ju njoftohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Bashkisë Korçë dhe Njesisë Administrative Voskop, Bashkia Korçë, për afishim në ambientet e tyre publike, 1(një) kopje dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Përbarimit; si dhe 2(dy) kopje iu njoftohen për publikim, Gazetës “Panorama” dhe Gazetës “Shqiptare”.

**PËRMBARUESE GJYQËSORE
BRUNILDA BICA**



**KRYETARE
OLTA SHKEMBI**

